



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	19.04.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	“Youth Initiative for Human Rights”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “Youth Initiative for Human Rights” me përfaqësues Kushtrim Morina me të cilën kërkohet që me datë 27 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi ”Skënderbeu”.

Qëllimi i aktivitetit është shënimi i Ditës Kombëtare për të pagjeturit në Kosovë ku do të vendoset një strukturë metalike me emrat e personave të zhdukur në luftën e fundit në vendin tonë. Struktura do të qëndroj e vendosur në Sheshin “Skënderbeu” nga data 27 Prill deri më 4 Maj 2021.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Skënderbeu” me datën 27 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHIP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.